



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:086595

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05684607

KE.nr.2045/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike të paditësit “Shtypshkronja LK” SH.P.K., me seli në rr. “Halim Orana” nr. 115, Dardania II, Gjilan, kundër të paditurit N.P.T. “Atalanta”, me seli në Gjilan, me objekt kontesti shpërblim dëmi, në seancën përgatitore të mbajtur me datë 14.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET e tërhequr padia me numër KE.nr.2045/22 e paditësit “Shtypshkronja LK” SH.P.K. kundër të paditurit N.P.T “Atalanta” me objekt kontesti shpërblim dëmi.
- II. Detyrohet paditësi “Shtypshkronja LK” SH.P.K që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, të ja paguaj të paditurit N.P.T. “Atalanta”, shumën prej 748.00€ në afat prej 7 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Paditësi paditësit “Shtypshkronja LK” SH.P.K., me datën 17.05.2017, ka paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Gjilan, për kompensim dëmi, kundër të paditurit N.P.T. “Atalanta”.

Gjykata me datë 14.05.2024 ka caktuar seancë përgatitore, në të cilën seancë nuk ka prezantuar përfaqësuesi i paditësit. Për shkak se ftesa nuk ka qenë e mundur ti dorëzohet në selinë e regjistruar në ARBK, gjykata në kuptim të nenit 114 të LPK-së ftesën për seancë e ka dorëzuar përmes tabelës së shpalljeve të publikuar me datë 26.04.2024 dhe tërhequr me datë 03.05.2024 sipas Aktvendimit KE.nr. 2045/22 të datës 26.04.2024 që komunikimi me paditësin të realizohet përmes tabelës së shpalljeve. Në këtë seancë ka prezantuar përfaqësuesi i të paditurit i cili gjykatës i ka propozuar që të konsiderohet e tërhequr padia e paditësit dhe ka kërkuar shpenzimet

e procedurës dhe atë për përpilimin e përgjigjes në padi shumë prej 104.00€, për një përgjigje në ankesë shumë prej 104.00€ dhe për katër seanca të mbajtura nga 135.00€ për çdo seancë, në shumë të përgjithshme prej 748.00€.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 409 paragrafin 1 të LPK-së, më të cilin përcaktohet se: *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet”*, ka marr aktvendim me të cilin e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në bazë të nenit 452 të LPK-së.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 409 par.1 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 2045/22, datë 14.05.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.